

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË
“ÇELMANI CUSTOMS AGENCY” SH.P.K

Sot, më datë 22/05/2025, bazuar në “LIGJ Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij”, si dhe në “LIGJ Nr.9723, datë 03/05/2007 “PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT” i ndryshuar”, ortakët themelues:

1. **Z.Tahir Çelmanaj**, shtetas shqiptar, lindur në Kalimash – Kukës më datë 25 Mars 1961, banues në Durrës, lagjia Nr.1 Rruga “Taulantia” Nd.45/1, Ap 19, H4, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal G10325086P.
2. **Z.Azem Çelmanaj**, shtetas shqiptar, lindur në Kalimash – Kukës më datë 30 Mars 1974, banues në Durrës, lagjia Nr.1 Rruga Currilave, Nd.2, Ap 24, H11, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal H40330072F.

Ortakët themelues, me vullnet të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**ÇELMANI CUSTOMS AGENCY**” Sh.p.k. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me parashikimet e këtij Statuti.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Emri, selia dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar dhe organizuar sipas së drejtës së Republikës së Shqipërisë. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj nën emrin “**ÇELMANI CUSTOMS AGENCY**” Sh.p.k.


Selia e Shoqërisë do të jetë : **pranë Degës së Doganës Morinë, Kukës.**

NENI 2

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të jetë si vijon:

- Agjensi doganore, përfshirë çdo aktivitet të lejuar dhe të parashikuar nga legjislacioni doganor i zbatueshëm, në lidhje me fushën përkatëse të veprimtarisë.



NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar, i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar.

NENI 4

Foma e Shoqërisë

Shoqëria organizohet si “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)” dhe gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe atyre të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

NENI 5

Ortakët e Shoqërisë

Shoqëria ka 2 (dy) ortakë të cilët zotërojnë shoqërinë në raportin e mëposhtëm:

1. **Z.Azem Çelmanaj**, zotërues i 1 (një) kuote, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 50%.
2. **Z.Tahir Çelmanaj**, zotërues i 1 (një) kuote, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 50%.

NENI 6

Përgjegjësia e ortakëve të Shoqërisë

Ortakët Themelues të Shoqërisë mbajnë përgjegjësi për humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara, në raport me pjesën që zotërojnë në Shoqëri.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

Ortakët e shoqërisë japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht për dëmet e shkaktuara nga mos përmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e cilitdo prej tyre, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo

dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesët e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në Ligj dhe gjithmonë duke respektuar të drejtën e parablerjes, në rastet kur kjo gjen zbatim. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 8

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100 000 lekë** (njëqind mijë lekë) dhe përbëhet vetëm nga kontributi në para. Ky kapital përbëhet nga **2 (dy) kuota**, i nënshkruar nga ortakët e saj themelues:

1. Ortaku **z.Tahir Çelmanaj**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë kontributi në kapital **50 000 lekë**, duke zotëruar 50% të pjesëmarrjes në kapital.
2. Ortaku **z.Azem Çelmanaj**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë kontributi në kapital **50 000 lekë**, duke zotëruar 50% të pjesëmarrjes në kapital.


NENI 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit bazë të Shoqërisë dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen vetëm nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin bazë;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- shitblerjes
- çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

Në rastet kur kjo gjen zbatim, Ortakët e Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes ndaj njëritjetrit. Përkatësisht, asnjë ndër ortakët nuk ka të drejtë ta shesë kuotën e tij tërësisht apo pjesërisht në favor të një të treti, apo të kalojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat e lidhura me të, pa ia ofruar paraprakisht me të njëjtat kushte ortakut tjetër.



Ortakut që dëshiron të shesë kuotën/pjesën e kapitalit që zotëron në Shoqëri njofton ortakët e tjerë me shkrim nëpërmjet “Njoftimit për shitje” duke u dhënë atyre 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së këtij njoftimi për të negociuar në lidhje me shitjen e kuotës/pjesës së kapitalit. Njoftimi për shitje duhet të përmbajë përqindjen e pjesës së kapitalit që ortakut do të shesë dhe çmimin e shitjes dhe kushtet e pagesës.

Në rast se në përfundim të afatit 30 ditor, ortakët nuk pranojnë të blejnë kuotën/pjesën e kapitalit të ortakut shitës ose heshtin, atëherë ortakut shitës ka të drejtë që të shesë kuotën/pjesën e kapitalit që ai zotëron në shoqëri tek të tretët me kushte jo më pak të favorshme se ato të ofruara ortakëve të shoqërisë. Shitblerja e kuotës e kryer në kundërshtim me këtë nen do të jetë absolutisht i pavlefshëm. Ortakët mund t'i transferojnë (me shitje ose dhurim) lirisht njëri - tjetrit kuotën e tyre. Në rast se secili ortak do të transferojë pronësinë e kuotës tek të tretët nëpërmjet dhurimit, atëherë ky dhurim duhet të shoqërohet me miratimin paraprak të Asamblesë së ortakëve.

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali bazë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë, duke e reflektuar ndryshimin në kapital në vlerën nominale të kuotës së zotëruar nga secili ortak, në vlerë të barabartë me kontributin individual të tyre. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi përpara publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të përfitojnë fitimet vjetore (dividend) të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë, në përputhje me kuotat e zotëruara prej tyre.

NENI 12

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria do t'i shpërndajë ortakëve fitimet e shoqërisë në fund të çdo viti financiar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- ✓ aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- ✓ shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 13

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Mbledhja e Asamblesë merr vendime për:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret detyrimisht nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo, në çdo mënyrë tjetër të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 15


Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16

Kuorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja

Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime me 3/4 (tre të katërtat) e ortakëve pjesëmarrës personalisht për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në këtë rast, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme nëse ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike.



Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme sipas ligjit tregtar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Në këtë rast, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme nëse ortakët që përfaqësojnë më shumë se 30 përqind të kuotave janë të pranishëm personalisht.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë pas mbledhjes së mëparshme, me të njëjtin rend dite.

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.

Ortakët, që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortakun, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i një kuote në shoqëri, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 17


Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i saj i zgjedhur nga radhët e ortakëve. Të gjitha vendimet e marra në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal i cili mbahet nga një person i caktuar nga ortakët për këtë qëllim. Administratorët kanë detyrimin të ruajnë kopjet e procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

Rregullat për emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve dhe kompetencat e tyre . Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë (individë) si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet specifike të Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga



Asambleja e Përgjithshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në pdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 19

Administratori

Administrator i vetëm i shoqërisë “ÇELMANI CUSTOMS AGENCY” Sh.p.k , do të jetë :

- **z.Azem Çelmanaj**, shtetas shqiptar, lindur në Kalimash – Kukës, më datë 30 Mars 1974, banues në Durrës, lagjia Nr.1 Rruga Curilave Nd.2, Ap 24, H11, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal H40330072F.

Administratori i sipërcituar emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me këtë statut të shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 20


Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorë ka të drejtë e detyrohet:

- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja;
- Të përfaqësojë shoqërinë;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë

Afati i emërimit, nuk mund të jetë me i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet specifike të Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në pdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të pëthjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

PRISHJA E SHOOËRISË (LIKUIDIMI)

NENI 21

Prishja e shoqërisë

Kjo Shoqëri do të priset në rastet e mëposhtme:


- Kur Asambleja vendos prishjen e saj;
- Me përfundimin e procedurave të falimentimit, ose në rastin kur pasuritë e shoqërisë nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- Në rast se objekti i aktivitetit të shoqërisë bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë tregtare;
- Në rastet se themelimi i shoqërisë është i pavlefshëm sipas nenit 3/1 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, kur pa-vlefshmëria është konstatuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Në raste të tjera, të parashikuara me ligj.

Prishja e shoqërisë regjistrohet nga administratorët në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 22

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuidator i emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja nuk merr një vendim për emërimin e likuidatorit brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidator. Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuidatorit të emëruar nga Asambleja, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidatori në fjalë mund të cenojë likuidimin e rregullt të shoqërisë. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuidatorit ..



Në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate, gjykata emëron likuidatorin. Likuidatori shkarkohet dhe zëvendësohet me të njëjtat kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre. Administratorët e shoqërisë regjistrojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuidatorit të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar shoqërisë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuidatori depoziton nënshkrimin e tij. Likuidatori gjithashtu regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit çdo ndryshim për identitetin ose tagrat e tyre të përfaqësimit. Likuidatori duhet të ftojë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Ata marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

Detyra e Likuiduesit është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 24


Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja.

NENI 25

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi i shpërndan ortakëve të shoqërisë aktivet e mbetura. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli i kthehen ortakut që i zotëron ato. Pas shpërndajës së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.



DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 26

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi pas regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 27

Dispozita kalimtare

Çdo çështje e cila nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, një kopje për Ortakët Themelues, një për tu arkivuar nga Shoqëria dhe një për t'u depozituar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Statuti nënshkruhet pa vërejtje nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Azem Çelmanaj

Azem Çelmanaj


Tahir Çelmanaj

Tahir Çelmanaj
